ardhur nga aksidenti në dëm të shëndetit të personave nuk janë klasifikuar dëmtime që përbënin fakt penal suipas dispozitës penale konkrete, në disa raste, megjithëse kanë rezultuar këto pasojë, nuk është provuar lidhja shkak-pasojë, si element i anës objektive të kësaj veprë penale. Është pushuar 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i K.Penal, me masë sigurimi arrest në burg me afat 1 muaj, ku pas kryerjes së aktit të ekspertimit mjekoligjorë për të dëmtuarin kanë rezultuar dëmtime të lehta dhe i dëmtuari e ka tërhequr ankimin pas normalizimit të marrëdhënieve me personin nën hetim. Një peshë tjetër të procedimeve penale të pushuara e zënë për veprën penale të parashikuara nga neni 248 i K.Penal, për shkak se ka rezultuar se fakti i ndodhur nuk parashikohej nga ligji si vepër penale. Janë pushuar 2 procedime penale me 1 person të arrestuar, për veprën penale të shkeljes së rregullave të mbrojtjes në punë dhe 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor me pasojë vdekjen e personit, në ato raste kur masa e sigurimit ka qenë e caktuar me afat në pritje të aktit të ekspertimit përkatës, teknik apo autoteknik. Është pushuar 1 procedim penal me 1 të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i K.Penal. Theksojmë se në të gjitha rastet e pushimit të çështjeve me persona të arrestuar, afati i paraburgimit ka qenë shumë i shkurtër, disa ditore.

*Janë pezulluar* 82 procedime penale për mosnjohje të autorit të veprës penale.

Peshën më të madhe të këtyre procedimeve penale vazhdojnë ta zënë vepra penale e vjedhjes (32 procedime penale) si dhe vepra penale e kultivimit të bimëve narkotike (20 procedime penale). Një vështirësi në hetimin e këtyre procedimeve penale ka qenë mbledhja e të dhënave dhe marrja e informacioneve qoftë edhe operative nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore për autorët e mundshëm të këtyre veprave penale. Kjo ka ndodhur edhe tek ato ngjarje ku janë fiksuar dhe marrë gjurmë papilare të vlefshme për krahasim me persona të dyshuar për veprën penale të vjedhjes. Po ashtu tek vepra penale e dytë ka patur problematikë në vonesat e kryerjes së aktit të ekspertimit kimik të bimëve të sekuestruara duke u bërë në disa raste edhe pengesë për zvarritjen e hetimeve me persona të paraburgosur.

*Janë transferuar* për në Prokuroritë e tjera 39 procedime penale me 53 persona nën hetim, ndër ta, 17 persona të arrestuar.

Shumica e procedimeve penale të transferuara janë për shkak të kompetencës tokësore me çështjet me të mitur, kryesisht për veprat penale të vjedhjes dhe drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, që i kanë kaluar për hetim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallë së Parë Shkodër, Seksionit për të Mitur.

Ka patur 1 procedim penal të regjistruar me 1 të pandehur të arrestuar për veprën penale të varësjes për gjakmarrje, i cili është transferuar për kompetencë lëndore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

*Janë dërguar për gjykim* 399 procedime penale me 344 të pandehur, ndër të cilët 50 me masën e sigurimit arrest në burg.

Peshën më të madhe të çështjeve të dërguara për gjykim e zënë për veprën penale të “*Mashtrimit në sigurime*” (171 çështje penale), më pas renditen për veprën penale të

parashikuar nga neni **248 dhe 248/a** (36 çështje penale), **42** çështje penale për veprën penale të **“Kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror”**, 31 çështje penale janë dërguar në gjyq për veprën penale të **“Drejtimin të automjeteve në mënyrë të parregullt”** dhe 21 çështje penale për veprën penale të **“Dhunës në familje”**. Gjithashtu janë dërguar në gjykim tre çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a i K.Penal dhe 1 çështje për veprën penale korrupsioni pasiv i personave që ushtrojnë funksione publike.

Për vitin 2016 janë përfunduar gjithsej 606 procedime penale.

Kanë mbetur në hetim për vitin vazhdues 109 procedime penale me 56 persona nën hetim.

**Më poshtë po i pasqyrojmë më hollësisht treguesit e ndjekjes penale**

### **VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT**

Nga viti 2015 janë mbartur 5 procedime penal me 8 të pandehur të arrestuar.

Janë regjistruar për vitin 2016 gjithsej 41 procedime penale me 39 të pandehur, ndër të cilët 19 me masë sigurimi arrest në burg. Gjatë këtij viti është regjistruar 1 procedim penal me 1 person të arrestur për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 të K.Penal, 1 procedim penal me 2 persona të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 78/1 i K.Penal, 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 78/a i K.Penal dhe 1 procedim penal me 1 person të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88/b i K.Penal.

Për këto vepra penale, gjatë vitit 2016 janë hetuar gjithsej 46 procedime penale me 47 të pandehur.

Janë pushuar 10 procedime penale, për shkaqe të tjera, për veprat penale të parashikuara nga nenet 88, 89, 99, 100/1, 110/1, 114/1 dhe 130/a/1 të K.Penal. Janë pushuar hetimet për 1 të pandehur të arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i K.Penal, për shkak se nga akti i ekspertimit mjekoligjorë kanë rezultuar dëmtime të lehta duke u kualifikuar vepra penale më pas plagosje e lehtë me dashje dhe i dëmtuari e ka tërhequr ankimin për këtë veprë penale, me kohëqindrimi në paraburgim 20 ditë.

Është pezulluar hetimi për mosnjohje të autorit për këto grup veprash penale për 1 procedim penal për veprën penale parashikuar nga neni 100/1 të K.Penal.

Janë transferuar për shkak të kompetencës tokësore dhe lëndore 4 procedime penale me 8 persona nën hetim, 1 prej tyre me masën e sigurimit arrest në burg.

Janë dërguar për gjykim 25 procedime penale me 28 të pandehur, ku 16 kanë qenë me masën e sigurimit arrest në burg.

Vlen të përmendim këtu, ndër të tjera, 1 procedim penal është për veprën penale të “*Vrasjes me dashje*”, mbetur në tentativë, me 1 të pandehur të arrestuar, 1 të pandehur të arrestuar për veprën penale të “*Përndjekjes*” dhe 21 procedime penale me 21 të pandehur, ndër ta, 16 të arrestuar, për veprën penale të dhunës në familje. Gjithsej për këto grup veprash penale, për vitin 2016 janë përfunduar 40 procedime penale.

Për vitin 2017 kanë mbetur në hetim 6 procedime penale me 5 persona nën hetim, ndër të cilët, 3 janë me masën e sigurimit arrest në burg për veprën penale të parashikuar nga neni 78/1 dhe 88/b të K.Penal.

*Parë në këndvështrim me vitin 2016 konstatohet se për këto grup veprash penale ka një rënjë të numrit të këtyre veprave penale në përgjithësi, të krimit kundër jetës së personit, të dhunës në familje në veçanti.*

### **VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË**

Janë mbartur nga viti i kaluar 24 procedime penale.

Gjatë vitit 2016 janë regjistruar 305 procedime penale.

Kanë ardhur me transferim nga Prokuroritë e tjera 8 procedime penale.

Gjithsej kanë qenë në hetim 337 procedime penale për këto vepra penale.

Janë pushuar për shakaq të tjera 40 procedime penale me 11 persona nën hetim, ku njëri prej tyre ka qenë i arrestuar për veprën penale të parashikuar nga neni 174/1 i K.Penal, kjo për shakaq të tjera, për shkak se fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale.

Peshën më të madhe të pushimeve të procedimeve e zënë për veprën penale të mashtrimit në sigurime (12 procedime penale), pastaj renditen për veprën penale të parashikuar nga neni 180/1 (6 procedime penale) dhe për veprën penale të parashikuar nga neni 186/1 (6 procedime penale). Është pushuar 1 procedim penal për veprën penale të trafikimit të mjeteve motorike dhe 1 procedim penal për veprën penale të mashtrimit, 3 procedime penale janë pushuar për veprat penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarive bankare dhe financiare, parashikuara nga nenet 170/c dhe 170/ç të Kodit Penal.

Janë pezulluar për mosnjohje të autorit të veprës penale 42 procedime penale.

Peshën më të madhe vazhdon ta zë vepra penale e vjedhjes (32 procedime penale).

Janë transferuar për në Prokuroritë e tjera 12 procedime penale.

Nga këto vepra penale, janë dërguar për gjykim 204 procedime penale me 154 të pandehur, ndër ta, 14 me masë sigurimi arrest në burg. Vendin kryesor të procedimeve penale të dërguar për gjykim për këto grup veprash penale e zënë për veprën penale të mashtrimit në sigurime (171 procedime penale), pastaj renditen për veprat penale në fushën e doganave (11 procedime penale), këtyre procedimeve penale e zënë vepra penale e vjedhjes (26 procedime penale), për veprën penale të vjedhjes (4 procedime penale) dhe për veprën penale të falsifikimit të dokumenteve 4 procedime penale, për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm 2 procedime penale.

Gjatë këtij viti, për këto grup veprash penale janë përfunduar 298 procedime penale, kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 39 procedime penale.

*Krahasuar me vitin e kaluar rezulton se janë regjistruar 44 procedime penale më shumë për veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë. Numrin më të madh të procedimeve vazhdojnë ta zënë vepra penale e mashtrimit në sigurime dhe ajo e vjedhjes së pasurisë, pastaj për veprat penale në fushën e doganave.*

*Ajo çfarë mund të theksohet krahasuar me vitin e kaluar është se kemi një rritje të numrit të çështjeve të dërguara për gjykim në krahasim me ato të pezulluara dhe të pushuara, që është në masën rreth 72%, por, vazhdojmë të kemi problematikë me hetimin e veprës penale të vjedhjes, ku nga 44 procedime penale të regjistruar për këtë vit, 32 prej tyre janë pezulluar për mosnjohje të autorit të veprës penale, vetëm 4 procedime penale janë dërguar për gjykim. Problematikë në hetimin e kësaj vepre penale ka qenë mungesa e mbledhjes së të dhënave dhe marrja e informacioneve në rrugë të ndryshme nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore për autorët e mundshëm të veprës penale. Kjo, ka ndodhur edhe tek ato ngjarje ku janë fiksuar dhe marrë gjurmë daktiloskopike të vlefshme për t'u krahasuar me persona të dyshuar. Një konsistim i tillë qëndron edhe për procedimet penale të regjistruara për këtë vepër penale në vitet e kaluara, të pezulluara më parë, të cilët janë pushuar për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për këtë vepër penale. Për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale janë pushuar 30 procedime penale, ku 7 prej tyre kanë patur gjurmë papilare të lënë nga autorët e veprës penale.*

### **VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT**

Nga viti 2015 është mbartur 1 procedim penal me 1 të pandehur.

Gjatë vitit 2016 janë regjistruar 4 procedime penale me 4 të pandehur në gjendje të lirë për veprën penale të prerjes së paligjshme të pyjeve.

Është pushuar 1 procedim penal për shkaqe të tjera, janë dërguar gjyqit 4 procedime penale me 4 të pandehur në gjendje të lirë.

### **VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHKETIT**

Nga viti 2015 janë mbartur 27 procedime penale.

Gjatë vitit 2016 janë regjistruar **222 procedime penale**, kanë ardhur me transferim **64 procedime penale**.

Gjithsej ka patur në hetim për këto grup veprash penale **316 procedime penale** me 242 persona nën hetim, 52 persona të arrestuar.

Janë pushuar për shkaqe të tjera 31 procedime penale me 16 persona nën hetim, dy prej tyre të arrestuar ( 1 i pandehur për veprën penale të parashikuara nga neni 290/1 i K.Penal dhe 1 i pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 298/3 i K.Penal).

Masa e sigurimit për veprën penale nga neni 290/1 të K.Penal ka qenë me afat, në pritje të aktit të ekspertimit përkatës, autoteknik dhe mjekoligjorë. Procedimet penale të tjera për këto grup veprash penale janë pushuar për shkaqe të tjera, për rastet kur fakti nuk parashikohej nga ligji si vepër penale tek vepra penale e shpërdorimit të detyrës, vetëgjyqësisë, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor dhe për veprën penale që ndiqet me ankimin e të dëmtuarit (neni 275 i K.Penal), për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror dhe në dy raste për veprën penale të shkeljes së rregullave të sigurimit teknik në punë.

Janë **pezulluar** për mosnjohje të autorit **40 procedime penale**. Peshën më të madhe të procedimeve penale të pezulluara e zënë për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike (20 procedime penale), pastaj renditen për veprën penale të dhënies ndihmë për kalim të paligjshëm të kufijve (8 procedime penale).

Janë **transferuar 23 procedime penale**.

Janë **dërguar gjyqit 158 procedime penale me 148 të pandehur**, ku 20 prej tyre kanë qenë me masën e sigurimit arrest në burg.

Nga procedimet penale të dërguara për gjykim vlen të përmendim: 36 procedime penale me 43 të pandehur, punonjës të administratës shtetërore, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 dhe 248/a i K.Penal, 3 të pandehur janë dërguar për gjykim për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/1 i K.Penal, 3 të pandehur për veprën penale të shkeljes së barzizë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, 8 procedime penale me 8 të pandehur për veprën penale të parshikuar nga nga neni 278 i K.Penal, 4 procedime penale me 11 të pandehur për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, 3 procedime penale me 3 të pandehur për veprën penale të kultivimit të bimëve narkotike, 3 procedime penale me 3 të pandehur për veprën penale të parshikuar nga neni 290 i K.Penal, 31 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, 42 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i K.Penal.

Gjatë vitit 2016 janë përfunduar gjithsej për këto grup veprash penale 252 procedime penale.

Kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 64 procedime penale.

*Krahasuar me vitin e kaluar, rezulton se gjatë vitit 2016 janë regjistruar 116 procedime penale më shumë për këto grup veprash penale. Nga treguesit konstatohet se ka një rënjë të veprës penale të prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit, shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor, të vetëgjyqësisë, por ka një rritje të veprave penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, të shpërdorimit të detyrës, të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve dhe kultivimit të bimëve narkotike, kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror, dhënies ndihmë për kalimin e paligjshëm të kufijve.*

## VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË

Për këto grup veprash penale nuk ka patur të mbartura nga viti 2015.

Gjatë vitit 2016 janë **regjistruar 10 procedime penale**. Ka ardhur me transferim 1 procedim penal. Gjithsej kanë qenë në hetim 11 procedime penale.

Janë **pushuar** për shkaqe të tjera 3 procedime penale për veprën penale të parashikuar nga nenet 301 dhe 306/1 dhe 317 të K.Penal.

Janë **dërguar gjyqit** 3 procedime penale me 8 procedime penale me 10 të pandehur në gjendje të lirë për veprat penale të parashikuara nga nenet 301, 305, 305/b, 306/1, 306/2 dhe 320 të K.Penal.

## TREGUESIT NË GJYKIM

### **Treguesit e përgjithshëm të çështjeve penale të gjykuara**

Nga viti **2015 janë mbartur në gjykim 39 çështje penale** me 59 të pandehur, ndër ta, 20 të pandehur me masën e sigurimit arrest në burg.

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për **gjykim 399 çështje penale** me 399 të pandehur, 50 me masën e sigurimit arrest në burg.

Gjithsej për vitin 2016 kanë qenë në gjykim 422 çështje penale me 422 të pandehur, ndër ta, 70 me masë siguri arrest në burg.

Për vitin **2016 janë gjykuar 230 çështje penale me 267 të pandehur**. Nga këto, janë gjykuar me gjykim të drejtpërdrejtë 2 çështje penale, me gjykim të zakonshëm 15 çështje penale, me gjykim të shkurtuar 208 çështje penale. Është bërë gjykimi në mungesë të të pandehurit për 5 çështje penale.

Për vitin 2017 kanë mbetur në gjykim **192 çështje penale me 11 të pandehur të arrestuar**.

*Nga prokurorët janë kërkuar këto lloje dhe masa dënimi:*

Për 83 të pandehur është kërkuar dënimi me gjobë, për 25 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 53 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 3 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 103 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë, për 2 të pandehur pushim çështje, kjo për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, në rastin kur është tërhequr ankimi në gjykim



nga i dëmtuari dhe për 1 të pandehur me masën e sigurimit arrest në burg, për veprën penale të parashikuar nga neni 232/a i K.Penal, pasi nga akti i ekspertimit psikiatriko-ligjor ka rezultuar se i pandehuri vuante nga sëmundje mendore e shkaktuar në kohën e kryerjes së veprës penale dhe të pandehurit i është caktuar masa mjekësore mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor.

*Në lidhje me kërkesat e bëra nga prokurorët, Gjykata ka dhënë vendime për lloje dhe masa dënimi si më poshtë:*

Për 81 të pandehur është vendosur dënimi me gjobë, për 43 të pandehur dënimi me burgim në minimum, për 18 të pandehur me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 105 të pandehur është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, për 15 të pandehur pushim çështje, për 6 të pandehur është vendosur pafajësi.

*Pafajësitë janë dhënë për të pandehurit në gjendje të lirë, për 2 të pandehur, akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 143/1 i K.Penal, për 2 të pandehur të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 186 i K.Penal, për 2 të pandehur të akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Për të gjitha pafajësitë e dhëna nga Gjykata, nga prokurori i çështjes është ushtruar ankimi në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe akoma nuk ka përfunduar gjykimi i tyre në shkallë të dytë.*

### **Më poshtë po i trajtojmë më hollësisht treguesit e çështjeve penale në gjykim**

#### **VEPRAT PENALE KUNDËR PERSONIT**

Nga viti 2015 kanë qenë mbartur në gjykim 3 çështje penale me 4 të pandehur.

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për gjykim 25 çështje penale me 28 të pandehur.

Për vitin 2016 kanë qenë në gjykim gjithsej 28 procedime penale me 32 të pandehur. Janë gjykuar gjithsej nga këto grup veprash penale 25 procedime penale me 27 të pandehur.

Për vitin 2017 kanë mbetur në gjykim 3 çështje penale me 5 të pandehur.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga Prokurorët:

Për 1 të pandehur dënim me gjobë, për 3 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 13 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 7 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim, për 1 të pandehur pushim çështje pasi është terhequr ankimi në gjykim nga i dëmtuari për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal.

Gjykata ka vendosur në përputhje me kërkesën e prokurorit.

*Dënimi me gjobë është kërkuar për 1 të pandehur, akuzuar për veprën penale të plagosjes nga pakujdesia. Pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim për pjesën e pavuajtur të dënimit është kërkuar për 6 të pandehur të arrestuar për veprën penale të dhunës në familje, në ato rrethana kur ka patur pasoja në shëndetin e të dëmtuarës, në rastet kur pas ngjarjes janë normalizuar marrëdhëniet mes viktimës dhe autorit bashkëjetues.*

### **VEPRAT PENALE KUNDËR PASURISË DHE EKONOMISË**

Nga viti 2015 janë mbartur në gjykim 20 çështje penale me 28 të pandehur.

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për gjykim 204 çështje penale me 154 të pandehur.

Për vitin 2016 kanë qenë gjithsej në gjykim 224 çështje penale me 182 të pandehur. Janë gjykuar gjithsej 99 çështje penale me 115 të pandehur.

Për vitin 2017 kanë mbetur në gjykim 125 çështje penale me 67 të pandehur me 4 të arrestuar.

*Në konkluzionet përfundimtare nga Prokurorët janë kërkuar këto lloje dhe masa dënimi:*

*Për 32 të pandehur dënim me gjobë, për 2 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 12 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 70 të pandehur pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.*

Nga gjykata është vendosur për 33 të pandehur dënimi me gjobë, për 1 të pandehur dënimi me burgim në minimum, me burgim mesatar për 7 të pandehur, për 66 të pandehur është vendosur pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim, për 6 të pandehur në gjendje të lirë është vendosur pushim çështje për veprat penale të parashikuara nga nenet 143/1, 186, 174/1 dhe 199 të K.Penal.

*Dënimi me gjobë është kërkuar në disa raste për veprën penale të kontrabandës me mallra të tjera, kur i pandehuri është gjykuar me masën e sigurimit garanci pasurore, duke patur parasysh llojin dhe sasinë e mallit kontrabandë, rrethanat e kryerjes së veprës penale, si dhe për veprën penale të mashtrimit në sigurime.*

### **VEPRAT PENALE KUNDËR MJEDISIT**

Nga viti 2015 nuk ka patur çështje të mbartur në gjykim për këto grup veprash penale.

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për gjykim 4 çështje penale me 4 të pandehur.

Është gjykuar 1 çështje penale me 1 të pandehur, për veprën penale të prerjes së paligjshme të pyjeve.

Kanë mbetur në gjykim për vitin vazhdues 3 çështje penale me 3 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 205 i K.Penal.

Për të pandehurit e gjykuar është kërkuar dënimi me gjobë dhe Gjykata ka vendosur dënimin me gjobë.

### **VEPRAT PENALE ME OËLLIME TERRORISTE**

Ka patur 1 çështje penale të mbartur në gjykim nga viti 2015 me 1 të pandehur të arrestuar për veprën penale të nxitjes, thirrjes publike dhe propagandës për kryerjen e veprave me qëllime terroriste. Për këtë të pandehur është vendosur caktimi i masës mjekësore, mjekimi i detyruar në një institucion mjekësor, pasi ka rezultuar se i pandehuri vuante nga sëmundje mendore në kohën e kryerjes së veprës penale.

### **VEPRAT PENALE KUNDËR AUTORITETIT TË SHTETIT**

Nga viti 2015 kanë qenë të mbartura në gjykim 13 çështje penale me 22 të pandehur.

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për gjykim për këto grup veprash penale 158 çështje penale me 148 të pandehur.

Për vitin 2016 kanë qenë gjithsej në gjykim 171 çështje penale me 171 të pandehur.

Janë gjykuar gjithsej 101 çështje penale me 116 të pandehur.

Për vitin 2017 kanë mbetur në gjykim për këto grup veprash penale 55 çështje penale.

Në konkluzionet përfundimtare janë kërkuar nga prokurorët këto lloje dhe masa dënimi:

Për 47 të pandehur dënim me gjobë, për 20 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 25 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 23 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë.

Gjykata ka vendosur për 43 të pandehur dënim me gjobë, për 25 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 8 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 1 të pandehur dënimi me burgim në maksimum, për 32 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vënia në provë. Për 5 të pandehur është vendosur pushim çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 248 (4 të pandehur në gjendje të lirë) dhe për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal (1 i pandehur me

masën e sigurimit arrest në burg me afat 30 ditë). Për 2 të pandehur është vendosur pafajësi për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Për rastet kur Gjykata ka vendosur pushimin e çështjes dhe pafajësi, nga prokurori i çështjes është apeluar vendimi në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku akoma nuk ka përfunduar gjykimi i tyre.

*Dënimi me gjobë është vendosur për veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit shtetëror, për veprën penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, ku drejtuesi i mjetit ka qenë pa leje drejtimi dhe më pas në respektim të nenit 53/a të K.Penal është vendosur zëvendësimi i dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.*

### **VEPRAT PENALE KUNDËR DREJTËSISË**

Nga viti 2015 kanë qenë të mbartur në gjykim 1 çështje penale me 3 të pandehur.

Gjatë vitit 2016 janë dërguar për gjykim 8 çështje penale me 10 të pandehur.

Për vitin 2016 kanë qenë gjithsej në gjykim 9 çështje penale me 13 të pandehur.

Janë gjykuar 4 çështje penale me 8 të pandehur.

Kanë mbetur në gjykim për vitin vazhdues 5 çështje penale me 5 të pandehur.

Për 2 të pandehur është kërkuar nga prokurori dënim me gjobë, për 3 të pandehur dënim me burgim mesatar, për 3 të pandehur është kërkuar pezullimi i ekzekutimit të vendimit me burgim.

Gjykata ka vendosur për 3 të pandehur dënim me gjobë, për 3 të pandehur dënim me burgim në minimum, për 2 të pandehur në gjendje të lirë për veprën penale të dëshmisë së rreme është vendosur pushim çështje. Dy vendimet e fundit të Gjykatës janë apeluar nga prokurori i çështjes në Gjykatën e Apelit Shkodër, ku akoma nuk ka përfunduar gjykimi i tyre.

## TREGUESIT E MASAVE TË SIGURIMIT

Gjatë vitit 2016 janë arrestuar në flagrancë nga policia gjyqësore 136 të pandehur.

Janë ndaluar me urdhër të Prokurorit 18 të pandehur.

Janë kërkuar dhe vleftësuar si të ligjshme në gjykatë 154 arrestime dhe ndalime.

Është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg për 88 të pandehur, për 2 të pandehur masa e sigurimit arrest në burg në mungesë, për 4 të pandehur arrest në shtëpi, për 2 të pandehur garanci pasurore, për 57 të pandehur detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore. Gjithsej janë kërkuar në gjykatë 156 masa shtrënguese.

Gjykata ka vendosur për 74 të pandehur masën e sigurimit arrest në burg, për 2 të pandehur arrest në burg, në mungesë, për 8 të pandehur arrest në shtëpi, për 6 të pandehur arrest në burg me afat, për 2 të pandehur garanci pasurore, për 62 të pandehur detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.

*Nga treguesit statistikor konstatohet se janë mbështetur nga gjykata kërkesat e prokurorit për caktimin e masës shtrënguese.*

*Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar në ato raste, për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të autorit, shtrirjen e veprës penale në vend. Masa e sigurimit arrest në burg është kërkuar për veprat penale kundër jetës së personit, tek vepra penale e vrasjes, plagosjes së rëndë me dashje, tek vepra penale e dhunës në familje, tek veprat penale kundër pasurisë dhe ekonomisë, siç kanë qenë vjedhja, trafikimi i mjeteve motorike, për krimet në fushën e doganave, si vepra penale e kontrabandës, si dhe tek veprat penale kundër autoritetit të shtetit, si kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik, tek veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, si shpërdorimi i detyrës, tek veprat penale kundër rendit dhe sigurisë publike, si prodhimi dhe shitja e narkotikëve, prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit, shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, kur drejtuesi i mjetit ka qenë recidivist në rastet kur ka qenë i pa pajisur me leje drejtimi apo kur drejtuesi i mjetit ka qenë në gjendje të dehur.*

*Masa shtrënguese të tjera është kërkuar në disa raste të veprës penale të kontrabandës me mallra të tjera, kur vlera e mallit kontrabandë ka qenë shumë e vogël, në veprat penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt, i pa pajisur me leje drejtimi, kur nuk kanë qenë persona recidivist dhe nisur nga mosha dhe personaliteti i të pandehurit. Një politikë penale e tillë ka ndikuar edhe në parandalimin e përgjithshëm që rezulton nga rënja e numrit të veprës penale të tillë në krahasim me vitin e kaluar.*

### **TREGUESIT E ZGJATJES SË AFATEVE TË HETIMEVE PARAPRAKE**

Janë zgjatur afatet deri në 3 muaj për 9 procedime penale me 11 të pandehur, 7 prej tyre kanë qenë të arrestuar. Mbi 3 muaj deri në 6 muaj janë zgjatur afatet për 3 procedime penal me 3 të pandehur të arrestuar për veprën penale të prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, kjo ka ndodhur si rezultat i pritjes së aktit të ekspertimit kimik të lëndës narkotike të sekuestruar.

*Siç shihet nga treguesit statistikor ka patur shpejtësi gjatë hetimeve paraprake, duke i kushtuar rëndësi zgjidhjes së duhur të procedimeve penale brenda afatit ligjor, duke garantuar dhe respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, si dhe dhënien e drejtësisë në kohë.*

### **TREGUESIT E MARRËDHËNIEVE JURIDIKSIONALE ME JASHTË**

Gjatë vitit 2016 janë paraqitur në Gjykatë 15 kërkesa për ekstradim për Jashtë Shtetit të personave të arrestuar në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të kërkuar nga Autoritetet e Shteteve të Tjera. Gjykata ka vendosur lejimin e ekstradimit për 12 persona, ka refuzuar ekstradimin për 3 persona.

Janë ekzekutuar 15 Letërporosi nga Jashtë Shetit, kryesisht nga Autoritetet e Drejtësisë Kosovare, që kanë patur të bëjnë me njoftimin e dëshmitarëve apo të pandehurit, pyetjen e dëshmitarëve, etj. Janë dërguar për Jashtë shtetit 15 letërporosi për marrjen e provave. Është bërë njohja e vendimeve penale të Gjykatave të Kosovës për 3 të dënuar, shtetas shqiptar.

### **TREGUESIT E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE PENALE**

Nga viti 2015 kanë qenë të mbartur vendime të të paekzekutuara për 20 të dënuar me burgim, për 42 të dënuar me gjobë dhe 35 të dënuar me kusht.

Gjatë vitit 2016 janë nxjerrë nga Prokuroria urdhërat e ekzekutimit të vendimeve penale për 71 të dënuar me burgim, për 107 të dënuar me gjobë, për 101 të dënuar me kusht.

Gjatë vitit 2016 rezultojnë të jenë ekzekutuar vendimet penale për 64 të dënuar me burgim, 1 të dënuar me gjobë, për 114 të dënuar me kusht.

Kanë mbetur të paekzekutuara për vitin në vazhdim vendimet penale për 27 të dënuar me burgim dhe 148 të dënuar me gjobë dhe 22 të dënuar me kusht.

## TREGUESIT E PUNËS PËR PROKURORËT

Gjate vitit 2016, nga ana e prokurorrëve të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës është përballuar një ngarkesë e konsiderueshme çeshtjesh penale dhe zhvillime gjykimesh pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kukës.

Më konkretisht po japim një tabelë përmbledhëse me të dhënat e ngarkesës së punës për secilin prokuror si dhe mënyrën e përfundimit të çeshtjeve prej tyre.

<b>Prokurori i çeshtjes</b>	<b>Nr. Proc</b>	<b>Proc. Përfunduar</b>	<b>Dërg. Gjyqit</b>	<b>Pushuar</b>	<b>Pezulluar</b>	<b>Transferuar</b>	<b>Hetim</b>	<b>Mosfillim</b>
R.Gjati	239	217	132	42	34	9	22	87
D.Prençi	71	63	51	2	4	6	8	15
F.Vata	151	151	104	14	11	11		69
E.Kariqi	198	140	90	18	21	11	58	109

Prokurore **Rita Gjati**, ka hetuar gjithsej 239 procedime penale, janë dërguar për gjykim 132 procedime penale, janë pezulluar 34 procedime penale, janë pushuar 42 procedime penale, janë transferuar 9 procedime penale, kanë mbetur në hetim 22 procedime penale. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 87 kallëzime penale. Janë studiuar 7 procedime penale të viteve të kaluara dhe më pas është vendosur pushimi i tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Është përfaqësuar akuza në gjykatë për 75 çeshtje penale. Gjykata ka vendosur 1 pafajësi për 1 të pandehur në gjendje të lirë dhe pushim për 3 çeshtje penale. Për këto vendime është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër dhe akoma nuk ka mbaruar gjykimi i tyre në shkallë të dytë. Janë paraqitur kërkesa në gjykatë për caktim mase sigurimi për 54 të pandehur, për 32 të pandehur është kërkuar arrest në burg, për 15 të pandehur detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, për 2 të pandehur garanci pasurore, për 4 të pandehur masa ndaluese pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik, për 1 të pandehur ndalimi i daljes jashtë shtetit.

Prokurori **Dritan Prençi**, i cili ka qenë edhe me funksionin drejtues i prokurorisë gjatë vitit 2016 ka hetuar gjithsej 71 procedime penale. Nga këto ka dërguar për gjykim 51 procedime penale, janë pezulluar 4 procedime penal për mosnjohje të autorit të veprës penale, janë pushuar 2 procedime penale, ka transferuar 6 procedime penal. Kanë mbetur në hetim për vitin në vazhdim 8 procedime penale. Është vendosur mosfillimi për 15 kallëzime penale. Po ashtu, ka përfaqësuar akuzën në gjyq për 26 çeshtje penale. Nga Gjykata janë dhënë pafajësi për 3 të pandehur në gjendje të lirë, 2 të pandehur për veprat penale të parashikuara nga nenet 186/3 të K.Penal dhe për 1 të pandehur për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Kundër vendimit të Gjykatës për pafajësinë e dhënë është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër. Për 1 të pandehur ka përfunduar

gjkimi në shkallën e dytë dhe Gjykata e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës dhe deklarin fajtor të të pandehurit për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal. Gjatë gjykimit prokurori Dritan Prençi nuk ka patur pushimi çështje, as ndryshim kualifikimi ligjor nga Gjykata.

Nga prokurori Dritan Prençi janë bërë në gjykatë kërkesa për caktimin e masës së sigurimit për 8 të pandehur, për 4 të pandehur është kërkuar masa e sigurimit arrest në burg, për 4 të pandehur të tjerë, detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore.

Prokurore **Fahrije Vata**, deri me datë 20 Nëntor, kohë kur ka vazhduar të jetë me raport mjekësore për shkak të shëndetit, ka hetuar gjithsej 151 procedime penale, janë dërguar për gjykim 104 procedime penale, janë pezulluar 11 procedime penale, janë pushuar 14 procedime penale, janë transferuar 11 procedime penale. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 69 kallëzime penale.

Janë studiuar 5 procedime penale të viteve të kaluara dhe më pas është vendosur pushimi i tyre për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale. Nga ana e prokurores Fahrije Vata është përfaqësuar akuza në gjykatë për 52 çështje penale. Nga Gjykata është vendosur pushim për 3 çështje penale, për 1 të pandehur me masën e sigurimit arrest në burg me afat një muaj për veprën penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal. Kundër vendimit të gjykatës është ushtruar ankim në Gjykatën e Apelit Shkodër, e cila ka vendosur lënjen në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës për 1 të pandehur, ndërsa për 2 çështjet e tjera, të pushuara nga Gjykata, vazhdon gjykimi në shkallën e dytë.

Nga prokurori Fahrije Vata janë paraqitur kërkesa në gjykatë për caktim mase sigurimi për 48 të pandehur, për 30 të pandehur është kërkuar arrest në burg, për 16 të pandehur detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, për 1 të pandehur arrest në shtëpi, për 1 të pandehur pezullimi i ushtrimit të një detyre a shërbimi publik.

Prokurori **Edmond Kariqi** ka hetuar gjithsej 198 procedime penale, janë dërguar për gjykim 90 procedime penale, janë pezulluar 21 procedime penale, janë pushuar 18 procedime penale, janë transferuar 11 procedime penale. Kanë mbetur në hetim 58 procedime penale. Është vendosur mosfillimi i procedimit penal për 109 kallëzime penale. Nga ana e prokurorit Edmond Kariqi është përfaqësuar akuza në gjykatë për 101 çështje penale. Nga Gjykata është vendosur pushim për 1 çështje penale me 2 të pandehur në gjendje të lirë. Për këtë vendim është ushtruar ankim dhe çështja akoma nuk është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Shkodër.

Janë studiuar dhe më pas është vendosur pushimi për 21 procedime penale të regjistruara në vitet e kaluara, pushimi i tyre është bërë për efekt parashkrimi të ndjekjes penale.

Për sa i përket masave të sigurimit nga ana e prokurorit Edmond Kariqi janë kërkuar masa sigurimi në gjykatë për 61 të pandehur, për 40 të pandehur arrest në burg, për 18 të pandehur detyrimi për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, për 2 të pandehur arrest në shtëpi, për 1 të pandehur shtrimi i përkohshëm në një spital psikiatrik.



## TREGUESIT E PUNËS PËR OFICERËT E POLICISË GJYQËSORE

Në mënyrë të përmbledhur, paraqesim ngarkesën e punës për oficerët e policisë gjyqësore.

<b>Nr.</b>	<b>Oficeri i Policisë Gjyqësore</b>	<b>Total i çeshtjeve</b>
1	Lulzim Aliaj	127
2	Vladimir Shehu	118
3	Bledar Xhoxha	134

Oficeri i Policisë Gjyqësore **Lulzim Aliaj** ka patur gjithsej në hetim 127 procedime penale. Nga këto, ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 4 procedime penale, për pushim 15 procedime penale, për gjykim 82 procedime penale. Ka mbartuar për vitin në vazhdim 19 procedime penale. Gjatë hetimit nuk ka patur deklarime të pavlefshëmrisë së akteve procedurale. Sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimit kanë qenë në unison me vendimmarrjen e prokurorit.

Oficeri i Policisë Gjyqësore **Vladimir Shehu** ka patur gjithsej në hetim 118, ka sugjeruar për pezullimin e hetimeve 5 procedime penale, për pushim 13 procedime penale, për gjykim 73 procedime penale. Ka mbartuar për vitin në vazhdim 23 procedime penale. Nuk ka patur pavlefshmëri aktesh si dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimit kanë qenë në përputhje me vendimin e marrë nga prokurori.

Oficeri i Policisë Gjyqësore, Seksioni i Policisë së Shtetit, **Bledar Xhoxha**, ka patur gjithsej në hetim 134, ka referuar për pezullimin e hetimeve 2 procedime penale, për pushim 4 procedime penale, për gjykim 103 procedime penale. Ka mbartuar për vitin në vazhdim 22 procedime penale. Gjatë hetimit nuk ka patur pavlefshmëri të ndonjë akti dhe sugjerimet për mënyrën e përfundimit të hetimeve kanë qenë në përputhje me vendimmarrjen e prokurorit.

## ADMINISTRIMI I PROKURORISË

Në mbarëvajtjen e punës së veprimtarisë në Prokurorinë Kukës, një rol të rëndësishëm kryen edhe administrata e prokurorisë. Rezulton së gjatë vitit 2016 është punuar në përmirësimin e punës së mbajtjes së regjistrave dhe raportimeve periodike të statistikave të prokurorisë. Gjithashtu është punuar për vënien në zbatim të sistemit CAMS.

Në lidhje me administrimin e prokurorisë gjatë vitit 2016 mund të themi se ka patur një administrim të drejtë për sa i përket zbatimit të buxhetit dhe kapaciteteve infrastrukturore të saj. Nuk ka patur probleme me sigurinë e brendshme për mbarëvajtjen e punës. Po

ashtu, janë krijuar marrëdhënie të besueshme me mediat dhe publikun duke dhënë informacion rreth përhapjes dhe goditjes së kriminalitetit për grup veprat penale që janë në rritje në vendin ku ushtron kompetencën territoriale kjo prokurori. Menaxhimi i brendshëm i Prokurorisë ka qenë sa më efikas, ka patur rregullsi në mbajtjen e regjistrave sipas praktikës së normuar të kësaj prokurorie. Po ashtu, ka patur korrektësi në ndjekjen e disiplinës dhe etikës në punë nga punonjësit.

Si përfundim, prioritet për vitin 2017 mbetet përfundimi në kohë të shpejtë i procedimeve penale të mbartura, rritja e shkallës së efektivitetit të ushtrimit të ndjekjes penale nëpërmjet hetimeve proaktive për veprat penale në fushën e doganave, të korrupsionit dhe krimit të organizuar, duke specifikuar goditjen e tek sistemi i drejtësisë.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**RITA GJATI**